

## AKT THEMELIMI

### Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “GLOBALTECH.AL” SH. P. K.

Sot, më datën 12.04.2024, **Z. Kundret Bojko**, i lindur në Korce, datë 03 Shtator 1994, mbajtes i kartes se identitetit me numer 037854965, banues ne Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **Z. Myrtjon Rexhepi**, i lindur në Durres, datë 19 Nentor 1990, mbajtes i Kartes se Identitetit me numer 034430848, banues ne Durres, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **Z.Nezir Bruçi** i lindur ne Qaf-Murrë , date 12 Maj 1989, mbajtes i kartes se identitetit me Nr.037323022, banues ne Kruje, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, **Z.Denis Kulla** i lindur ne Durres, date 14 Shkurt 1986 , banues ne Durres, mbajtes i kartes se Identitetit me Nr.033375601, madhor me zotesi te plote per te vepruar, vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**GLOBALTECH.AL** “ Sh. P. K. si më poshtë vijon

#### Neni 1

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “**GLOBALTECH.AL**” SH.P.K

Ortakë të kësaj shoqërie janë **Z. Kundret Bojko, Z.Myrtjon Rexhepi, Z.Nezir Bruçi dhe Z.Denis Kulla.**

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z. Kundret Bojko.**

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

#### Neni 2

Shoqëria “**GLOBALTECH.AL**“ Sh.P.K gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Sh. P. K.**”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Qendra e saj është Durres, Lagjia Lagjia nr.8, Rruga “A.Goga”, Njesi me Nr.Pasurie 5/316/ND-N2 , Vol.53, Fq.49, Zone Kadastrale 8512 , Durres.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

#### Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe te pa caktuar.

#### Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitet me objekt:

- Riparimi i pajisjeve elektronike dhe informatike.

- Krijimi dhe instalimi i programeve software, krijimi dhe instalimi i pajisjeve elektronike hardware, instalime elektrike, kondicionimi
- Instalime dhe shitje te sistemeve te sigurise, ruajtje objektesh me sisteme elektronike, marketing dhe kerkim tregu, kancelari, tonera.

#### Neni 5

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Lekë. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera i mëposhtë:

- Z. Kundret Bojko zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përbën 25% të kapitalit të shoqërisë.
- Z. Myrtjon Rexhepi zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përbën 25% të kapitalit të shoqërisë.
- Z. Nezir Bruçi zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përbën 25% të kapitalit të shoqërisë.
- Z. Denis Kulla zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përbën 25% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë ( pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta ). Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakeve të saj.

#### Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### Neni 8


Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKËT E SHIQËRISË.

KUNDRET BOJKO



MYRTJON REXHEPI



NEZIR BRUÇI



DENIS KULLA

